



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1/2023 regjistër (JR)
Datë 10.01.2023

Nr. 7 i vendimit
Datë 29.01.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen që i përket:

KËRKUES: Subjekti i rivlerësimit Ilir Turja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 584, datë 07.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 63 dhe 66/1, shkronja “b”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 584, datë 07.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Subjekti i rivlerësimit Ilir Turja (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së¹, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

(i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;

(ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë;

(iii) ka mosdeklarime në vite;

(iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;

(v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2. DSIK-ja², në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, i ka përcjellë Komisionit raportin me nr. {***} prot., datë 17.08.2022, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZh-së nr. {***}, datë 19.09.2022, në të cilin ka konfirmuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, duke i lënë në vlerësim të Komisionit informacionet e raportuara nga institucioni i verifikimit, sipas së cilave ngriheshin dyshime për përfshirje në korrupsion aktiv të subjektit të rivlerësimit, përpara periudhës së rivlerësimit.

3.3. KLP-ja³, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burime arkivore të KLP-së, i ka përcjellë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ilir Turja.

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 04.01.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit Ilir Turja, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

² Fillimisht ka dërguar raportin me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZh-së nr. {***}, datë 19.09.2022, në të cilin ka konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ilir Turja.

³ Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ilir Turja, me nr. {***} prot. (protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 15.06.2021).

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ilir Turja, për të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në pikat 1/c dhe 3, të nenit 58, pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 584, datë 07.11.2022, vendosi: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Turja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës [...]”*, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi rezulton se: (i) *ka kryer fshehje të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; si dhe (iii) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë.*

II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Ilir Turja

5. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), ku kërkon ndryshimin e vendimit nr. 584, datë 07.11.2022, të Komisionit dhe gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke paraqitur shkaqet procedurale te ankimit dhe shkaqe ankimore, të cilat kanë lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes.

6. Shkaqet procedurale të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

6.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit është i padrejtë, pasi është marrë si pasojë e konstatimit të gabuar të situatës faktike, në kundërshtim të hapur me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe në zbatim të gabuar të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

7. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

7.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për fshehje të pasurisë, me pretendimin se pasurinë “Banesë trekatëshe”, në përdorim prej tij, e ka deklaruar rregullisht si vendbanim në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën ka deklaruar edhe burimin e krijimit të saj.

7.2. Sipas subjektit, Komisioni duhet ta kishte përllogaritur vlerën e ndërtimit të banesës në vitin 2003, sipas preventivit të punimeve dhe jo sipas çmimeve të referencës të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave [në vijim “EKB”]. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë faktin se babai i tij kishte kontribuar në kryerjen punimeve dhe, për rrjedhojë, kostoja e ndërtimit për këtë pasuri ka qenë më e ulët se çmimi minimal fiskal.

7.3. Subjekti ka pretenduar se balanca negative për ndërtimin e banesës trekatëshe në vitin 2003, është pasojë e mosreflektimit në analizën financiare të burimeve të përdorura për ndërtimin e saj, si: a) kursimet familjare ndër vite; b) shuma prej 500.000 lekësh e investuar nga babai i tij; c) investimi i shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në vlerën 3.480.000 lekë; ç) huaja e marrë nga babai i tij, në shumën 1.950.000 lekë, si dhe fakti se analiza financiare për subjektin duhet të kryhej së bashku me prindërit për periudhën 2003 – 2013, duke përfshirë vitin 2009, moment kur subjekti është shkëputur përkohësisht për të jetuar në Tiranë dhe është rikthyer në vitin 2010.

7.4. Subjekti ka pretenduar se shuma prej 620.000 lekësh, që rrjedh nga vlerësimi që banka i ka bërë mobilieve të pasurisë në analizë, të mos konsiderohet nga Komisioni si shpenzim për mobilim për periudhën 1995 – 2003, pasi vlerësimi është bërë më i lartë, me qëllim akordimin e kredisë nga banka.

7.5. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se përllogaritja e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1995 – 2003, nga Komisioni në vlerën 1.503.456 lekë, ekuivalente me 88.4% të të ardhurave të prindërve, është e gabuar, për rrjedhojë, ai ka pretenduar që ato të rillogariten.

7.6. Subjekti ka kundërshtuar mënyrën e përllogaritjes së vlerës së punimeve për ndërtimet shtesë të kryera pas vitit 2010, duke pretenduar se në përcaktimin e vlerës së tyre, Komisioni duhet t'i referohej çmimeve të referencës të përcaktuara nga EKB-ja.

7.7. Subjekti ka pretenduar se kursimet *cash* të akumuluar për periudhën 2009 – 2010, në shumën prej 1.000.000 lekësh, në vitin 2011, nuk janë përdorur për të financuar mobilimin/ kompletimin e restorantit, sikurse ka konkluduar Komisioni, por për ndërtimet shtesë të kryera në banesën trekatëshe.

7.8. Lidhur me pasurinë “Apartament banimi” në Tiranë, me sipërfaqe 67,8 m², në pronësi të bashkëshortes, subjekti ka pretenduar se pasaktësia në deklarin e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e tij.

7.9. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar që balanca negative e konstatuar nga Komisioni në shumën rreth 1.300.000 lekë, të vlerësohet nga Kolegji sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, si një balancë negative e vogël që nuk mund t'i justifikojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ilir Turja, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit⁴, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit,

⁴ Sipas vendimit nr. {***}, datë 29.12.2022, për pranimin e ankimit, rezulton se subjekti ka depozituar në Komision ankimin e datës 27.12.2022, i cili është administruar me nr. {***} prot., datë 27.12.2022.

përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 584, datë 07.11.2022, bazuar në shkaqet e ngritura në ankim, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet procedurale të ankimit

11. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit është i padrejtë, pasi është marrë si pasojë e konstatimit të gabuar të situatës faktike, në kundërshtim të hapur me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe në zbatim të gabuar të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

11.1. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, që gjejnë zbatim, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit lidhur me vendimin e Komisionit janë të përgjithshme dhe të pambështetura në fakte e rrethana konkrete, që do të mund të dëshmonin në drejtim të shkeljes së pretenduar. Subjekti i rivlerësimit nuk veçon ndonjë nga përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por referon në përgjithësi këtë dispozitë, duke pretenduar se ajo është interpretuar në mënyrë të gabuar nga Komisioni. Në këtë këndvështrim, në vlerësim të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit kundërshton në thelb zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ndërsa sa i takon pretendimit të tij për vendimmarrje në kundërshtim me provat, nuk referon ndonjë fakt apo provë. Trupi gjykues, nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni ka shqyrtuar shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dhe bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe prova të mundshme shtesë. Në këto kushte, pretendimi i subjektit gjendet i pabazuar.

11.2. Lidhur me analizimin dhe shqyrtimin e provave nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se provat e administruara nga Komisioni dhe ato të paraqitura nga subjekti, janë vlerësuar në mënyrë objektive, në përputhje me përcaktimet e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

12. Në përfundim, për sa më sipër, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti akte shkresore bashkëlidhur ankimit, si dhe në analizë të shkaqeve procedurale të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se nuk gjendemi në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që do të legjitimonin shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar. Në këto kushte, çështja u shqyrtua bazuar në gjendjen që ishin aktet e administruara nga Komisioni, në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit

13. Për pasurinë “Banesë në përdorim”, regjistruar sipas vërtetimit hipotekor me nr. {***}, datë 05.11.2003, me nr. {***} pasurie, me adresë Lagjja {***}, Plazh, në Durrës, në emër të babait, B. T., Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar

pasuritë; si dhe (iii) ka kryer fshehje të pasurisë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara sipas leximit a contrario të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pasuri të fshehur, duke pretenduar se pasurinë “Banesë trekatëshe”, në përdorim prej tij, e ka deklaruar rregullisht si vendbanim në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën ka deklaruar edhe burimin e krijimit të saj, dhe se të drejtat e tij të përdorimit janë kufizuar në pjesën shtesë të objektit të ndërtuar pas vitit 2010, konkretisht një kat banimi, si dhe në katin e parë të objektit, ku bashkëshortja e tij zhvillon aktivitetin bar-restorant.

15. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton si më poshtë vijon:

15.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën *përshkrim i pasurisë dhe burimi i krijimit*, subjekti ka deklaruar: “Banesë, ku aktualisht jetoj me prindërit, regjistruar sipas vërtetimit hipotekor me nr. {***}, datë 05.11.2003, me nr. {***} pasurie, me adresë Lagjja {***}, Plazh, në Durrës, në emër të babait, B. T.”. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare [në vijim “BKT”] në shumën 6.000.000 lekë, si dhe kursimet familjare, pa përcaktuar vlerë apo pjesë takuese të tij në këtë pasuri.

15.2. Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës *vetting*, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në BKT, në shumën 6.000.000 lekë, sipas kontratës së datës 25.10.2010. Në vijim të deklarimit të tij, subjekti ka shpjeguar se qëllimi i marrjes së kredisë ka qenë porosia për blerjen e një apartamenti sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 15.09.2010. Por më vonë, për arsye objektive, kjo kontratë është revokuar me deklaratë noteriale për revokim kontrate sipërmarrjeje të datës 12.02.2011, dhe shuma e kredisë së marrë është investuar në banesën e prindërve të tij, objekt shqyrtimi.

15.3. Në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, duke filluar nga viti 2003 e në vijim, subjekti ka deklaruar vetëm adresën e banimit: “Lagjja {***}, Plazh Durrës”. Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2010, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: “Kredi në shumën 6.000.000 lekë, me afat 15 vjet, marrë në BKT Durrës - në nëntor 2010”. Gjithashtu, rezulton se kjo kredi, si detyrim financiar, shlyerja e saj dhe vlera e mbetur është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratat vijuese të interesave privatë periodikë vjetorë.

15.4. Nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës⁵ (në vijim, ASHK), është konfirmuar për Komisionin se, nga verifikimi i bërë në sistemin digjital të të dhënave, rezulton se pasuria në analizë është e regjistruar në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, B. T., dhe se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk figurojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme.

15.5. Nga shqyrtimi i akteve të administruara për subjektin e rivlerësimit, si dhe shpjegimeve të paraqitura prej tij në Komision⁶, trupi gjykues konstaton se kjo pasuri/banesë është ndërtuar mbi

⁵ Shkresë nr. {***} prot., datë 05.11.2020, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Durrës.

⁶ Referuar përgjigjeve dhe dokumentacionit të përcjellë nga subjekti në Komision, së bashku me përgjigjet e pyetësorit standard.

truallin me sipërfaqe 300 m², i blerë nga babai i subjektit, B. T., në vitin 2002, në vlerën 900.000 lekë⁷. Në këtë truall është ndërtuar një banesë trekatëshe, me sipërfaqe totale ndërtimi 270.68 m², nga shoqëria “{***}” ShPK. Referuar preventivit të punimeve, i cili gjendet bashkëlidhur kërkesës për leje ndërtimi, vlera e këtij ndërtimi është përllogaritur në shumën 5.549.892 lekë⁸.

15.6. Me vendimin e datës 08.10.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁹, në datën 22.10.2009 është regjistruar në regjistrat hipotekorë, në emër të shtetasit B. T., pasuria “Banesë trekatëshe”, nga e cila kati përdhe me sipërfaqe 91.06 m², kati i parë me sipërfaqe ndërtimi 92.81 m² dhe kati i dytë me sipërfaqe ndërtimi 92.81 m². Objekti ka një sipërfaqe totale ndërtimore prej 276.68 m².

15.7. Në datën 09.07.2010, me vendimin nr. {***}, të KRRT-së Durrës,¹⁰ në objektin ekzistues trekatësh është ndërtuar një shtesë anësore, dy kate bodrum dhe papafingo.¹¹ Referuar dokumentit deklarativ “Për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”, protokolluar në Drejtorinë e ALUIZNI-t, Durrës, në datën 30.09.2015, ky ndërtim (objekt) deklarohet se është ngritur në vitin 2013. Bazuar në lejen e legalizimit të sipërcituar, në datën 01.03.2017, në regjistrat hipotekorë, në emër të shtetasit B. T. është regjistruar pasuria shtesë anësore *2 kate bodrum + papafingo* në objektin ekzistues 3-katësh: (a) sipërfaqe bodrumi social-ekonomik 58 m², (b) sipërfaqe kati përdhe social-ekonomik 128 m², (c) sipërfaqe kati i parë 154 m²; (ç) sipërfaqe kati i dytë 160 m²; dhe (d) sipërfaqe papafingoje 71 m², pra është rritur sipërfaqja totale ndërtimore nga 276,68 m² në 566 m². Për këtë pasuri, po në datën 01.03.2017, është lëshuar edhe certifikata e pronësisë. Në vijim, në datën 16.10.2017, ASHK, Drejtoria Vendore Durrës ka regjistruar në emër të babait të subjektit, dy objekte, njëri me sipërfaqe 32 m², me përshkrim të veçantë *godinë social-ekonomike 1 kat + shtesë anësore në objekt ekzistues 3 kate*, dhe 41 m², me përshkrim të veçantë *godinë social-ekonomike 1 kat + shtesë anësore në objekt ekzistues 3 kate*, të cilat janë legalizuar në datën 19.04.2017, si dhe janë regjistruar në emër të B. T., në datën 08.11.2018.

15.8. Sipas dokumentacionit, punimet për shtesat e kryera në objektin ekzistues, të ndërtuar në vitin 2003, janë kryer nga shoqëria “{***}”¹² ShPK, nga muaji shkurt i vitit 2010 e deri në vitin 2011, moment kur marrëdhënia mes palëve është ndërprerë, ndërkohë që ishin kryer vetëm 62% të punimeve¹³. Në deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”, me nr. {***}, datë 30.09.2015, pjesë e dosjes së legalizimit, citohet se ndërtimi është kryer në vitin 2013. Shtesat janë legalizuar me lejen me nr. {***}, datë 11.01.2017 dhe certifikata e pronësisë është lëshuar në datën 01.03.2017, në emër të B. T. Ndërsa dy ndërtimet, me sipërfaqe 32 m² dhe 41 m², janë legalizuar në datën 19.04.2017, dhe janë regjistruar në emër të z. B. T., në datën 16.10.2017.

⁷ Me anë të kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 20.05.2002. Sipas Vërtetimit hipotekor me nr. {***}, të datës 20.05.2002, z. B. T. rezulton pronar i pasurisë “Truall me sipërfaqe 300 m²”.

⁸ Referuar Vërtetimit hipotekor me nr. {***}, datë 05.11.2003, banesa është regjistruar në emër të z. B. T.

⁹ Lënë në fuqi me vendimin e datës 16.6.2009, të Gjykatës së Apelit Durrës.

¹⁰ Me vendimin nr. {***}, që lidhet me mbledhjet e datave 22, 23, 25, 28, 29 dhe 30.6.2010, të KRRT-së Durrës.

¹¹ Miratuar leja e ndërtimit me vendimin nr. {***}, të datës 09.07.2010, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Durrës.

¹² Sipas kontratës së datës 03.02.2010, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të nënshkruar mes z. B. T., në cilësinë e porositisit (investitorit) dhe shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit.

¹³ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një deklaratë noteriale të shtetasit B. T. (përfaqësues dhe ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK), në të cilën ai ka deklaruar se ndërprerja e marrëdhënies mes tyre nuk ishte vlerësuar të formalizohej me ndonjë dokument, për sa kohë nuk ka pasur kontradikta mes tyre.

15.9. Referuar preventivit të punimeve, vlera e punimeve ishte parashikuar në shumën 12.327.088 lekë, për ndërtimin me sipërfaqe 590 m², por sipërfaqja totale e ndërtimit ka rezultuar 566 m². Komisioni, në konsideratë edhe të vlerës së preventivit, ka përllogaritur vlerën e punimeve të kryera *de facto* (566 m²), në shumën 12.000.000 lekë. Ndërsa për dy ndërtimet me sipërfaqe 32 m² dhe 41 m², Komisioni e ka përllogaritur koston e tyre në vlerën rreth 2.160.000 lekë, referuar udhëzimeve të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitet 2010, 2011 dhe 2013”¹⁴. Pra, totali i sipërfaqeve të ndërtuara në vitet 2010 – 2013 në objektin kryesor dhe për ndërtimin e dy objekteve të tjera shtesë anësore, është përllogaritur nga Komisioni në shumën 14.160.000 lekë, shumë për të cilën subjekti dhe prindërit kanë rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

15.10. Sikurse është përshkruar në mënyrë të detajuar më sipër, përdorimi i kësaj pasurie nga subjekti dhe prindërit ka filluar në vitin 2003. E drejta për të ndërtuar këtë pasuri nga babai i subjektit të rivlerësimit, rezulton të jetë fituar në vitin 2003, por edhe nëpërmjet përfitimit nga zbatimi i procesit të legalizimit, të kryer nëpërmjet Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale, sa i takon zhvillimit të kësaj pasurie gjatë viteve 2010 – 2013, kur janë kryer punime shtesë, janë ndërtuar ambiente të reja, është rritur sipërfaqja ndërtimore nga 276,68 m² në 566 m², si dhe ka ndryshuar funksioni për disa ambiente. Në kohën e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndërtimet shtesë ishin legalizuar. Leja e legalizimit shënon momentin e fitimit të pronësisë në kuptimin ligjor, për objektet e ndërtuara në rrugë informale.

15.11. Trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë në përdorim, duke referuar një dokument, i cili nuk tregonte gjendjen faktike të saj (por atë të vitit 2003), ndërkohë që, pavarësisht pjesës që kishte në përdorim, ka pasur detyrimin të deklaronte edhe gjendjen aktuale/faktike të pasurisë, vlerën dhe burimin e krijimit të saj.

15.12. Referuar nenit 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” [në vijim “ligji nr. 9049/2003”] përcaktohet se “objekt deklarimi” janë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, si dhe detyrimi i subjektit të rivlerësimit për deklarimin e burimit, shoqëruar me dokumentacionin ligjor që provon ligjshmërinë e tij. Në këtë optikë, ndonëse pronar *de jure* i pasurisë në analizë identifikohet babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e titullarit të të drejtave reale të përdorimit dhe banimit, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për deklarimin e pasurisë në përdorim, duke filluar nga viti 2003 e në vijim. Nga ana tjetër, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të plotësonte deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij ligji, në të cilën parashikohet qartësisht deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

15.13. Trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i të dhënave të plota të kësaj pasurie në përdorim dhe i gjendjes faktike të saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *vetting*, bëjnë që subjekti i rivlerësimit të gjendet në situatën e deklarimit të pasaktë, sipas kërkesave të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion mbështetet në rrethanat evidentuara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, i cili ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit shënohet

¹⁴ Kostoja mesatare e ndërtimit për vitet 2010 – 2013, për qytetin e Durrësit, paraqitet në vlerën 29.580 lekë/m². Pra, vlera totale e ndërtimit të këtyre dy objekteve ka qenë (sipërfaqja totale ndërtimi 73 m² * 29.580 lekë/m² = 2.159.340 lekë).

si “investitor” në preventivin që shoqëron relacionin teknik - të projektit të vitit 2010, për ndërtimin e shtesave; (ii) në datën 25.10.2010, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur para noterit dokumentacionin në lidhje me lejen e ndërtimit të dhënë nga KRRT Durrës; (iii) pasuria e regjistruar në emër të babait të tij është lënë si kolateral për marrjen e kredisë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2010, në BKT; (iv) kati përdhës i pasurisë është vendi i ushtrimit të aktivitetit tregtar “bar-restorant”, nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

15.14. Përpos sa më sipër, në konsideratë të faktit se subjekti ka përdorur në vijimësi këtë pasuri, ka deklaruar se ka kontribuar financiarisht në krijimin e saj, si dhe faktit se bashkëshortja e subjektit ka përdorur katin e parë të kësaj pasurie për ushtrimin e aktivitetit tregtar, në vlerësimin e trupit gjykues rrethanat e sipërpërshtkruara përbëjnë fakte determinuese në favor të një situate të dyshuar, se prindërit e subjektit mund të mbajnë pasuri të fshehura të tij, pavarësisht se pronari *de jure* ishte babai i subjektit të rivlerësimit.

15.15. Trupi gjykues i Kolegjit, ashtu sikurse edhe Komisioni, vëren se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor mundësinë financiare të ligjshme të prindërve të tij për krijimin e pasurisë, si dhe nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë vlerën e investimeve të kryera prej tij, për ndërtimet shtesë të kryera në godinën ekzistuese trekatëshe, të ndërtuar në vitin 2003, të cilën subjekti e ka pasur në përdorim pa ndërprerë, gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit.

15.16. Trupi gjykues ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar¹⁵ dhe të harmonizuar, nëpërmjet së cilës ka analizuar në mënyrë shteruese, rëndësinë vendimtare që kanë saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të zbatimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Formulimi i kësaj dispozite për deklarimin e pamjaftueshëm të pasurisë, konkretizon përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për një kontroll të plotë dhe vlerësim të drejtë të kriterit të pasurisë, konform përcaktimeve ligjore. Procesi i vlerësimit të kriterit të pasurisë zërthehet në nenet 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë parimet dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të subjektit të rivlerësimit për të kryer deklaram të saktë, për të provuar burimet e ligjshme financiare dhe mungesën e konfliktit të interesit.

15.17. Deklarimi i plotë dhe i saktë i investimeve të kryera në pasurinë në përdorim nga ana e subjektit të rivlerësimit, përbën një detyrim ligjor për subjektin, gjë e cila e bën më të lehtë kryerjen e një analize ekonomike/financiare, mbi të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur mbi këtë investim të kryer, në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në rastin konkret, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të kundërtën e barrës së provës në kuadër të procesit të rivlerësimit, përcaktuar nga neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

16. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram të pasaktë sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit sa i takon ndërtimit të banesës trekatëshe, në vitin 2003, trupi gjykues konstaton sa vijon:

17. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar mënyrën e përlllogaritjes së kostos së punimeve për ndërtimin e banesës në vitin 2003, bazuar në çmimet e referencës sipas EKB-së, duke pretenduar se investimi ka qenë në shumën 5.549.892 lekë, sikurse pasqyrohet në preventivin e punimeve, të hartuar nga një

¹⁵ Shih vendimin nr. 21/2023 (JR), datë 06.06.2023; vendimin nr. 19/2023 (JR), datë 26.04.2023.

ekspert i licencuar i fushës, i cili plotëson kriteret për të qenë dokument ligjor dhe është pjesë e dosjes së lejes së ndërtimit. Sipas subjektit, përfshirja e babait të tij në kryerjen e punimeve është një faktor që ka ndikuar në uljen e kostos së ndërtimit, nën çmimin minimal fiskal.

17.1. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, për përlllogaritjen e kostos së shpenzimeve sipas preventivit të punimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje se, referuar legjislacionit në fuqi në vitin 2003¹⁶, kur ka përfunduar ndërtimi sipas vërtetimit të pronësisë, parashikohej se objektet e ndërtuara duhet t'i nënshtroheshin kolaudimit teknik-ekonomik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të ndodhur në dosjen e pronës, lidhur me analizimin e kostos së ndërtimit të pasurisë në analizë, trupi gjykues konstatoi se në aktin e kolaudimit nuk janë evidentuar procesverbalet për punimet e kryera dhe nuk rezulton që kolaudatori të ketë verifikuar situacione apo vlera që mund të ndihmonin në përlllogaritjen përfundimtare të objektit në këtë fazë, referuar Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"¹⁷. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se mbetet e pakonfirmuar sa ka qenë kostoja reale e ndërtimit të banesës trekatëshe, për sa kohë, nga ana e subjektit, nuk janë vënë në dispozicion situacionet e punimeve, të shoqëruara me faturat tatimore përkatëse të shoqërisë ndërtuese "{***}" ShPK. Ndërsa, në lidhje me preventivin e ndodhur në dosjen e lejes së ndërtimit, trupi gjykues vlerëson se ai nuk vërteton punimet e kryera, por parashikon vlerën e punimeve që do të kryheshin. Nga ana tjetër, ulja e kostos së ndërtimit nën çmimin minimal fiskal, duket se është bërë me qëllimin për të pasur një ngarkesë takse më të ulët në momentin e regjistrimit të pronës¹⁸.

17.2. Në analizë të rrethanave faktike, trupi gjykues vlerëson se referimi që Komisioni ka bërë tek Udhëzimi nr. 1, datë 08.05.2003, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit 'K'" ¹⁹, çmohet si një standard i arsyeshëm dhe në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit²⁰, me qëllimin për t'i vendosur të gjitha subjektet e rivlerësimit në një trajtim të barabartë në mënyrën e përlllogaritjeve të vlerave të pasurive të tyre, në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues për vlerën e ndërtimeve.

18. Lidhur me pretendimin e subjektit për konsiderimin e kontributit të babait të tij në kryerjen e ndërtimeve për objektin trekatësh, përmes angazhimit të tij në kryerjen e punimeve, nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, ndonëse e përmend këtë pretendim të subjektit, nuk ka arsyetuar lidhur me të. Pavarësisht mungesës së arsytimit nga ana e Komisionit lidhur me këtë rrethanë, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit është i pabazuar për arsyet në vijim.

¹⁶ Shih nenin 48, ligji nr. 8405/1998; nenin 3, shkronja "a" e ligjit nr. 9482/2006, të ndryshuar.

¹⁷ Në pjesën e dytë, për kolaudimin e punimeve të ndërtimit citohet: "Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi: a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes".

¹⁸ Në referim të nenit 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, "Për urbanistikën", në të cilin parashikohet se "Personi fizik dhe juridik, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit, duhet të paguajë 1 % të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit".

¹⁹ Sipas së cilit kostoja rezulton në shumën prej rreth 7.500.000 lekësh (sipërfaqe totale ndërtimi 276.68 m² * 27.218 lekë/m² = 7.530.676 lekë. Referuar sipërfaqes së ndërtimit dhe kostos mesatare të ndërtimit për metër/katror, për qytetin e Durrësit, që është 27.218 lekë/m.²

²⁰ <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-D.-Rr.-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>

18.1. Së pari, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument/provë në mbështetje të këtij pretendimi, sikurse kërkon përcaktimi i nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe pika 26, e Udhëzimit të ILDKPKI-së²¹, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Së dyti, referuar Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, ku si elemente të strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit përfshihen 3 kategori: 1. shpenzimet e drejtpërdrejta; 2. shpenzimet e përgjithshme; 3. fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), nuk rezulton që puna e krahut të mund të përllogaritet veçmas në kuadër të përcaktimit të kostos së ndërtimit. Në këto rrethana, si dhe në referencë të jurisprudencës së Kolegjit²², trupi gjykues vlerëson se shpenzimet për fuqinë punëtore nuk u provuan dhe nuk konsiderohen si të zbritshme dhe, për rrjedhojë, e gjen pretendimin e subjektit të rivlerësimit të pabazuar.

19. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e analizës financiare për periudhën 1995 – 2013, së bashku me prindërit, duke konsideruar në këtë analizë si burim për ndërtimin e banesës trekatëshe, në vitin 2003, të: a) kursimeve familjare ndër vite, pa përcaktuar ndonjë vlerë; b) shumës prej 500.000 lekësh, e parapaguar nga babai i tij ndaj shoqërisë së ndërtimit; c) investimit nga shoqëria “{***}” ShPK, në shumën 3.480.000 lekë; ç) huas së marrë nga babai i tij, në shumën 1.950.000 lekë, trupi gjykues konstaton sa vijon:

19.1. Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, ka pranuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, deri në fund të vitit 2003, ai dhe prindërit kanë funksionuar si një ekonomi e përbashkët familjare dhe, në këtë kuptim, një pjesë e të ardhurave të përfituara prej tij nga puna mund të jenë administruar nga babai i tij dhe të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive dhe/apo mbulimin e shpenzimeve të prindërve deri në fund të vitit 2003. Megjithatë, Komisioni ka kryer më vete analizën financiare të prindërve (persona të tjerë të lidhur) dhe analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 1995 – 2003. Analiza financiare e subjektit, për periudhën 1995 – 2003, rezulton me balancë pozitive fondesh në vlerën 1.450.000 lekë dhe Komisioni e ka vlerësuar këtë vlerë si mundësinë e kursimit të subjektit të rivlerësimit, duke e përfshirë në analizën financiare të ardhurat e prindërve të subjektit, të cilat mund të kenë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie objekt vlerësimi.

19.2. Trupi gjykues konstaton se, pavarësisht faktit se në vitin 2001, subjekti është shkëputur nga trungu familjar, *de facto*, ai ka vijuar të banojë në të njëjtën banesë me prindërit, pra në një regjim të përbashkët pasuror, së paku deri në fund të vitit 2003, moment i cili përkon me fillimin e deklarimit, si dhe ndërtimin e pasurisë “Banesë trekatëshe”. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se, për një analizë garantiste, të pranojë pretendimin e subjektit të rivlerësimit

²¹ Për rastet kur subjektet e rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të kanë kryer ndërtime, shitesa ose rikonstruksione të pjesshme ose të plota, për banesa ose çdo ndërtim tjetër, duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë ligjor, lejen e ndërtimit, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj.

²² Paragrafët 33, 34, 35 në vendimin nr.15/2019, datë 17.07.2019, subjekti rivlerësimit D. Rr.: “Në këtë vlerësim, nuk u konsideruan si vlera hipotetikiqisht të zbritshme: kostoja për hartimin e projektit të ndërtimit dhe as ajo e shpenzuar për fuqinë punëtore, të cilat në vlerësimin e Kolegjit janë shpenzime të kryera detyrimisht për ndërtimin e një godinë prej 5 katesh, pavarësisht se vlera e tyre mund të jetë e ndryshme nga ajo që përcakton struktura e çmimit për metër katror, sipas përcaktimeve të EKB-së”.

se, deri në fund të vitit 2003, ka funksionuar si një ekonomi e përbashkët familjare me prindërit e tij, duke e vlerësuar balancën pozitive në vlerën rreth 1.450.000 lekë, si mundësi e kursimit të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, si një ndër burimet për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi.

20. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, si gjatë hetimit të kryer nga Komisioni²³, ashtu edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, konsiderimin si burim për krijimin e pasurisë në vitin 2003, të shumës prej 500.000 lekësh, me burim nga kursimet familjare, të parapaguar nga babai i tij, si dhe të investimit të kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, në shumën prej 3.480.000 lekësh. Subjekti ka parashtuar se babai i tij, z. B. T., kishte rënë dakord verbalisht me z. N. R. (përfaqësues dhe ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK) për parapagimin e shumës prej 500.000 lekësh, për ndërtimin e banesës. Nga ana tjetër, z. N. R. kishte marrë përsipër të investonte shumën prej 3.480.000 lekësh, për realizimin e punimeve, kundrejt përfitimit të katit përdhes të banesës. Në pamundësi për të përfunduar punimet, ky i fundit ka hequr dorë nga marrëveshja e mëparshme, ka ndërprerë punimet dhe ka dakordësuar me babain e subjektit të rivlerësimit, për kthimin e shumës 3.480.000 lekë, të investuar nga kjo shoqëri për kryerjen e punimeve, dhe likuidimin e kësaj shume gjatë periudhës 2004 – 2010. Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës në Komision deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2022, të z. N. R., ku parashtrohen rrethanat e sipërpërkshkruara, fakti se shuma prej 500.000 lekësh është parapaguar rreth muajit gusht të vitit 2003, si dhe faktin se shuma 2.980.000 lekë (3.480.000 – 500.000 lekë), i është likuiduar kësaj shoqërie nga z. B. T., gjatë periudhës 2009 – 2010.

20.1. Në lidhje me shumën prej 500.000 lekësh, të pretenduar si burim për ndërtimin e banesës trekatëshe në vitin 2003, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare, me arsyetimin se nuk është deklaruar dhe provuar me dokumentacion justifikues ligjor burimi i krijimit të saj. Megjithatë, nga analiza financiare e kryer për periudhën 1995 – 2003, nga Komisioni, si edhe ajo e rishikuar në Kolegj, subjekti dhe prindërit e tij rezultojnë me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme, për krijimin e shumës prej 500.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti si të parapaguar në vitin 2003.

20.2. Në lidhje me pretendimin e subjektit për konsiderimin e shumës prej 3.480.000 lekësh të pretenduar nga subjekti, si të investuar nga shoqëria “{***}” ShPK, sikurse është parashtuar më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor, për të provuar marrëdhënien e pretenduar mes babait të tij dhe shoqërisë, si dhe marrëveshjen mes tyre për përfitimin nga shoqëria në fjalë, të njërit kat të banesës, në shkëmbim të investimit që ajo do të kryente. Në këto kushte, pretendimi i subjektit konsiderohet deklarativ dhe i pabazuar në prova dhe, si i tillë, nuk mund të merret në konsideratë.

20.3. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shuma prej 3.480.000 lekësh, i është kthyer shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, deri në fund të vitit 2010, në mbështetje të të cilit, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të përfaqësuesit të kësaj shoqërie, trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi të jetë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, në referencë edhe të jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit, lidhur me mënyrën e vlerësimit dhe marrjes në konsideratë të deklaratave noteriale²⁴ të hartuara në funksion të procesit të

²³ Në përgjigje të pyetësorit standard.

²⁴ Paragrafi 41.2, në vendimin nr. 5/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. K.; paragrafi 26.2, në vendimin nr. 23/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. D. P.; paragrafi 57, në vendimin nr. 3/2021, datë 26.01.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. H.

rivlerësimit, duke i konsideruar këto akte me vlerë të kufizuar për sa ato kërkojnë të provojnë, vlerësohet se dokumenti i paraqitur nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të vërtetuar marrëdhënien mes investitorit B. T. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për përfitimën prej saj të katit të parë të banesës, në shkëmbim të investimit që do të kryente kjo shoqëri.

20.4. Për sa më sipër, trupi gjykues ndan të njëjtin konkluzion me Komisionin, se edhe nëse do të konsiderohej pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e shumës prej 3.480.000 lekësh, si të investuar nga shoqëria “{***}” ShPK, në analizën financiare, duke qenë se subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është kthyer shoqërisë deri në fund të vitit 2010, do të thellohej edhe më tej balanca negative për periudhën 2004 – 2013.

21. Lidhur me pretendimin e subjektit për përllogaritjen e balancave pozitive të rezultuara nga analiza financiare për secilin vit, në formën e mundësisë së kursimit për periudhën 2004 – 2008, në shumën 2.530.957 lekë, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare, me arsyetimin se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*.

21.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje përcaktimet e ligjit nr. 9049/2003, i cili, pavarësisht nga ndryshimet ndër vite²⁵, parashikon në mënyrë qartë detyrimin për subjektet deklaruese (në nenet 4 dhe 7 të tij), për të pasqyruar çdo ndryshim të ndodhur në pasuri, detyrimet financiare dhe interesat privatë, si dhe gjendjen e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* apo në bankë, në fund të çdo viti, prej vitit 2003 e në vijim. Referuar nenit 6 të po këtij ligji, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave privatë, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: “*Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat/pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit*”.

21.2. Po ashtu, Kolegji në jurisprudencën²⁶ e tij është shprehur se ekzistenca e kursimeve nuk mund të prezumohet nga organet e rivlerësimit, mbështetur vetëm në pretendimin për balanca pozitive të disa viteve të periudhës objekt kontrollit, por duhet të jetë evidentuar në deklaratat periodike të interesave, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces, në bazë të parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe që janë prova e vetme mbi të cilën provohet ekzistenca e një pasurie, siç janë likuiditetet *cash* në banesë, që më pas luajnë një rol kyç në paraqitjen e situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, kur pretendohen se kanë ekzistuar dhe se kanë shërbyer si burim për krijimin e një pasurie. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se diferenca hipotetike pozitive e analizës financiare për vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2008, në shumën 2.530.957 lekë, duhej të konsiderohej si mundësia e tij reale për kursim, pavarësisht se nuk është deklaruar, është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por dhe alogjik në kuptim të përllogaritjes së këtyre të ardhurave për procesin e rivlerësimit.

22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për konsiderimin në analizën financiare si një ndër burimet për blerjen e truallit në vitin 2002 dhe ndërtimin e banesës trekatëshe në vitin 2003, edhe huan e marrë nga babai i tij, z. B. T., nga z. A. M., në shumën prej 1.950.000 lekësh, në muajin shkurt të vitit 2002, pa afat dhe pa interes.

²⁵ Ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006, me ligjin nr. 85/2012, datë 18.09.2012, si dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014.

²⁶ Shih vendimin nr. 26/2021 (JR), datë 04.08.2021.

22.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikull, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë noteriale të z. A. M., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2022, në të cilën z. A. M. deklaron se i ka dhënë z. B. T. huan në shumën prej 1.950.000 lekësh. Bashkëlidhur kësaj deklarate, gjendet një kontratë me nr. {***} rep., me nr. {***} kol., datë 12.02.2002, për shitjen e një pasurie të paluajtshme, të ardhurat e së cilës, sipas shpjegimeve të subjektit gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, si dhe në ankimin e depozituar në Kolegj, kanë shërbyer si burim për dhënien e huas. Konkretisht, subjekti ka parashtruar, ndër të tjera, se duke qenë se huadhënësi jetonte dhe punonte në Itali, që prej vitit 1991, dhe banesa që dispononte në Shqipëri nuk i nevojitej, i kishte kërkuar ndihmë babait të subjektit, z. B. T., për shitjen e saj. Subjekti ka sqaruar se të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie nuk i nevojiteshin z. A. M., pasi bëhej fjalë për një vlerë relativisht të vogël, për një emigrant që ka jetuar dhe punuar në Itali që nga viti 1991. Gjithashtu ka rezultuar se nga viti 2002 e në vijim, huadhënësi nuk ka kryer asnjë investim në Shqipëri dhe kjo është arsyeja, sipas subjektit, pse kthimi i kësaj huaje ka qenë i panevojshëm gjatë këtyre viteve për të.

22.2. Në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare të kryer për prindërit e subjektit, huan e pretenduar nga subjekti, të marrë nga babai i tij, për shkak se e ka cilësuar si një pretendim deklarativ dhe të paprovuar me dokumentacion justifikues ligjor të kohës. Komisioni ka arsyetuar, ndër të tjera, se në mungesë të evidentimit të lidhjes së posaçme familjare të babait të subjektit dhe z. A. M., duket jashtë logjike lënia në përdorim dhe pa kundërshtim për mbi 20 vjet të shumës 1.950.000 lekë, në favor të babait të subjektit të rivlerësimit.

22.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për këtë hua, trupi gjykues çmon se: (i) në mungesë të një marrëdhënie të posaçme mes babait të subjektit dhe huadhënësit; (ii) vlerës së huas prej 1.950.000 lekësh, e cila është një shumë e konsiderueshme për t'u dhënë në mirëbesim; si dhe (iii) mbajtjes për një kohë të gjatë të kësaj shume (huaja nuk është kthyer edhe gjatë procesit të rivlerësimit), si dhe në kushtet kur argumenti i vetëm i subjektit ishte se huadhënësit nuk i nevojitej shuma prej 1.950.000 lekë, besueshmëria e pretendimit të subjektit vështirësohet, në kufijtë e të pamundurës.

22.4. Gjithashtu, në vlerësim të trupit gjykues, në kuptim të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet si një parakusht detyrimi për konfirmimin e marrëdhënies së huas, e më pas detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm për dhënien e huas, çka të rikthen tek nevoja apo domosdoshmëria e ekzistencës së një akti noterial apo dokumenti, në kuadër të *konfirmimit të marrëdhënies, nëse me të vërtetë ekziston kjo marrëdhënie*. Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se deklaratimet për burimet e krijimit të pasurive, duhet të gjejnë pasqyrim në përputhje me ligjin, në deklaratën *vetting* dhe ato periodike, përndryshe subjektet vihen në kushtet e pamundësisë për të vërtetuar me deklarime të mëpasshme ekzistencën e tyre, në funksion të procesit të rivlerësimit, për sa kohë nuk ka gjurmë të kohës, së këtyre marrëdhënieve²⁷. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë burimet e krijimit të kësaj pasurie, çka vjen në kundërshtim me parashikimet e pikave 2 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës,²⁸ për detyrimet

²⁷ Shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024, subjekti i rivlerësimit M. Sh.

²⁸ Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

që kanë subjektet e rivlerësimit në plotësimin e deklaratës së rivlerësimit të pasurisë, si dhe Udhëzimin nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

22.5. Ndërsa, në lidhje me deklaratën noteriale të z. A. M., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës për të dokumentuar marrëdhënien e huas, trupi gjykues, bazuar edhe në qëndrimet që ka mbajtur Kolegji²⁹ në çështje të ndryshme, çmon se megjithëse deklarata nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, i pyetur në seancë dëgjimore nga vëzhguesi ndërkombëtar, nëse është kthyer shuma e pretenduar si e marrë hua prej babait të tij, në shkurt të vitit 2002, nga huadhënësi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë ende nuk është kthyer.

22.6. Në këndvështrim të sa më sipër, si dhe në mungesë të evidentimit të ndonjë marrëdhënieje të posaçme të babait të subjektit me shtetasin e sipërpërmendur, trupi gjykues çmon se duket jashtë logjike lënia në përdorim dhe pa kundërshtpërblim, për mbi 20 vjet, e shumës 1.950.000 lekë, në favor të babait të subjektit të rivlerësimit, për më tepër kjo shumë nuk është deklaruar si burim në deklaratën *vetting*, por është pretenduar gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

22.7. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për konsiderimin në analizën financiare të të ardhurave nga huaja e marrë nga babai i tij, në shumën 1.950.000 lekë, fakt i padeklaruar në deklaratën *vetting* dhe as në DPV-në 2003, mbeti në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokumentacion justifikues ligjor të kohës, referuar standardit ligjor dhe jurisprudencës së Kolegjit, pavarësisht burimit të krijimit të huas.

23. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e analizës financiare sa i takon shumës prej 620.000 lekësh, të përlllogaritur nga Komisioni si shpenzime mobilimi për periudhën 1995 – 2003, me pretendimin se shpenzimet për mobilim ishin kryer nga prindërit e tij, jo vetëm gjatë periudhës së mësipërme, por edhe përpara vitit 1995, trupi gjykues në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe shpjegimeve të tij gjatë procesit të rivlerësimit³⁰, por edhe pas kalimit të barrës së provës, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzime mobilimi dhe as nuk ka qartësuar vlerën, kohën dhe burimin konkret të të ardhurave, të cilat kanë mbuluar shpenzimet për mobilimin/arredimin e pasurisë në përdorim të tij. Për më tepër, duket se subjekti ka shmangur përgjigjet konkrete sa i përket këtij zëri, duke pretenduar se janë përdorur mobiliet dhe pajisjet elektro-shtëpiake që kanë pasur te banesa në Shijak. Në shpjegimet e tij, subjekti ka referuar një vlerë minimaliste për rinovimin e mobilieve, të shpenzuar për çdo vit (40.000 lekë/në vit³¹), e cila duket se nuk i përgjigjet realitetit social-ekonomik dhe nuk është në përpjesëtim me sipërfaqen ndërtimore të objektit.

²⁹ Shih vendimet: nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2; nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 26.2; dhe nr. 11/2021 (JR), datë 31.03.2021, paragrafi 26.2, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

³⁰ Në përgjigje të pyetësorëve 2 dhe 3, të dërguar nga Komisioni.

³¹ Përgjigje e pyetjes nr. 14, në pyetësorin nr. 1.

23.1. Nga shqyrtimi i kontratës së kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit në “ProCredit Bank”, në datën 08.09.2004, në shumën prej 500.000 lekë, me qëllim rinovimin e banesës, në pikën 4 të saj përcaktohet garancia (pengu), sipas Aneksit A, që i bashkëlidhet kësaj kontrate, ku listohen mobilet e banesës të përllogaritura nga banka në vlerën 620.000 lekë, si dhe një automjet³². Subjekti ka pretenduar se vlera e vendosur në dokumentin bankar është rritur për efekt të marrjes së kredisë bankare. Po ashtu, pjesë e kësaj kontrate është edhe një deklaratë e datës 08.09.2004, e dhënë nga subjekti i rivlerësimit për bankën, ku ai ka deklaruar se është pronar i sendeve të listuara në deklaratë (mobilitëve dhe një autoveture).

23.2. Nisur nga sa më sipër, duket se shpjegimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, sipas së cilave subjekti ka pretenduar se shpenzimet për mobilim janë kryer nga kontributi i përbashkët familjar gjatë periudhës 1995 – 2003, vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e deklaratës së depozituar prej tij në bankë, në të cilën ai ka deklaruar se është pronar i mobilitëve të lëna si garanci për marrjen e kredisë në “ProCredit Bank”, në datën 08.09.2004.

23.3. Sa i takon vlerës së këtyre mobilitëve të përllogaritur nga banka, në shumën 620.000 lekë, trupi gjykues çmon të mbajë në konsideratë faktin se politikat e bankave në vlerësimin e garancive synojnë një vlerësim më të ulët, referuar vlerës së tregut për të njëjtat sende, me qëllim mbulimin e riskut dhe kthimin sa më të shpejtë të tyre në likuiditete dhe jo rritjen e tyre, sikurse ka pretenduar subjekti. Po ashtu, trupi gjykues çmon të evidentojë faktin se banesa e ndodhur në Shijak, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka jetuar në harkun kohor të mësipërm, është shitur në vlerën 230.000 lekë. Për rrjedhojë duket alogjike që vlera e mobilitëve të asaj banese, të ketë qenë rreth trefish më e lartë se vetë vlera e banesës. Ndërsa, lidhur me pretendimin e subjektit për përllogaritjen e këtij shpenzimi në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare të subjektit me prindërit, për periudhën 1995 – 2003, në eventualitetin e fakteve të sipërpërsëhkuara, trupi gjykues vëren se rrethanat e konstatuara, mbështesin konkluzionin dhe vlerësimin e Komisionit lidhur me shpenzimet e mobilimit dhe, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit lidhur me të gjenden të pabazuara.

24. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se shpenzimet e jetesës, për periudhën 1995 – 2003, janë përllogaritur nga Komisioni në vlerën 1.503.456 lekë, ekuivalente me 88.4% të të ardhurave të prindërve. Kjo mënyrë përllogaritjeje sipas subjektit është e gabuar dhe, për rrjedhojë, ai ka kërkuar të rillogariten nga Kolegji shpenzimet e jetesës.

24.1. Nga verifikimi i shpenzimeve të jetesës për prindërit e subjektit, të përllogaritura nga Komisioni rezulton se, për periudhën 1995 – 1998, janë llogaritur shpenzimet e jetesës 5.000 lekë/muaj për person, ndërsa për vitin 1999 shpenzimet e jetesës janë përllogaritur njësoj me shpenzimet e jetesës për dy persona për vitin 2000, sipas INSTAT. Për periudhën 2000 – 2003, shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas INSTAT-it.

24.2. Trupi gjykues i Kolegjit referuar praktikës së Kolegjit³³, nisur edhe nga fakti se subjekti ka qenë me gjendje civile beqar dhe në përbërje familjare me prindërit për periudhën 1995 – 1999, si dhe duke

³² Në aneksin “garanci objekteve”, që lidhet me kontratën e kredisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është pronar i të mirave, duke u evidentuar lista e pengut, si vijon: (i) dy TV + video + magnetofon, me vlerë 50.000 lekë; (ii) dy frigoriferë + lavatriçe, me vlerë 70.000 lekë; (iii) sobë gatimi, sobë gazi, me vlerë 30.000 lekë; (iv) katër tavolina + dy komplete divanesh, me vlerë 120.000 lekë; (v) kuzhinë + minibar + 2 dy dhoma gjumi, me vlerë 350.000 lekë; dhe (vi) autoveturë “Mercedes-Benz”, me vlerë 550.000 lekë.

³³ Shih vendimin nr. 15/2019 (JR), datë 18.06.2019, si dhe nr. 5/2022 (JR), datë 15.03.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

mbajtur në konsideratë periudhën tranzitore të viteve 1997–1998, ku minimumi jetik lidhet vetëm me nevojat ekzistenciale të ushqimit dhe jo të privilegjeve të tjera, në funksion të një analize financiare shteruese, kreu korrigjimin e shpenzimeve të jetesës për prindërit e subjektit, duke i përllogaritur shpenzimet e jetesës sa 30% e vlerës së të ardhurave të tyre. Ndërsa për periudhën 2000 – 2003, shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas INSTAT-it. Nga ky korrigjim konstatohet se shpenzimet totale të jetesës për të dy prindërit për periudhën 1995 – 2003, rezultojnë në vlerën prej 999.396 lekësh, krahasuar me vlerën prej 1.503.456 lekësh, të përllogaritur nga Komisioni. Ndërsa në lidhje me subjektin e rivlerësimit, shpenzimet e jetesës, të cilat nga Komisioni ishin përllogaritur në shumën prej 1.942.116 lekësh, nga analiza e rishikuar në Kolegj rezultuan në shumën prej 1.216.417 lekësh.

Lidhur me ndërtimet shitesë të kryera në godinën ekzistuese të banimit, të ndërtuar në vitin 2003

25. Subjekti ka pretenduar se kostoja e punimeve për ndërtimet kryera gjatë periudhës 2010 – 2013, si për shitesat e kryera në godinën ekzistuese të banimit, ashtu edhe në lidhje me dy objektet me sipërfaqe përkatësisht 32 m² dhe 41 m², duhet të ishte përllogaritur nga Komisioni sipas çmimeve referencë të EKB-së.
26. Trupi gjykues, në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni e ka përllogaritur koston e ndërtimeve shitesë bazuar në preventivin e punimeve, sipas së cilit vlera totale e parashikuar për ndërtimin e shitesës anësore, papafingo dhe punime të tjera në objektin ekzistues, ka qenë në shumën 12.327.088 lekë³⁴. Sipas projektit, sipërfaqja ndërtimore do të ishte 590 m², ndërkohë që në përfundim të ndërtimeve, objekti ka rezultuar me një sipërfaqe prej 566 m². Për rrjedhojë, Komisioni ka përllogaritur koston për sipërfaqen faktike në shumën rreth 12.000.000 lekë.
27. Gjithashtu, nga aktet ka rezultuar se është ndërtuar edhe një bodrum, kostoja e së cilit nuk ishte përllogaritur në preventivin e punimeve. Referuar shpjegimeve të subjektit, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, shoqëria e ndërtimit ka kryer vetëm 62% të punimeve, pasi në shkurt të vitit 2011, babai i tij i ka kërkuar ndërtuesit ndërprerjen e punimeve dhe zgjidhjen e marrëveshjes së sipërcituar me shoqërinë “{***}” ShPK³⁵.
- 27.1. Trupi gjykues i Kolegjit, duke mbajtur në konsideratë faktin se kostoja e ndërtimit e përllogaritur sipas preventivit të punimeve dhe faturave të lëshuara nga shoqëria ndërtuese, të cilat dokumentojnë volumin më të madh të punimeve të parashikuara, ka një diferencë të konsiderueshme me vlerën e punimeve sipas çmimeve referencë të përcaktuara nga EKB-ja, për më tepër në kushtet kur në vlerën e preventivit nuk ishte përfshirë ndërtimi i bodrumit, arrin në përfundimin se rrethanat e evidentuara më sipër mbështesin vendimmarrjen e Komisionit, në përllogaritjen e koston së punimeve shitesë të

³⁴ Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit gjatë hetimit disa fatura nga shoqëria “{***}” ShPK., konkretisht: (i) në muajin tetor 2010 janë kryer punime me vlerë 2.884.559 lekë; (ii) në muajin nëntor 2010 janë kryer punime me vlerë 3.088.116 lekë; (iii) në muajin dhjetor 2010 janë kryer punime me vlerë 535.128 lekë; (iv) në muajin janar 2011 janë kryer punime me vlerë 1.054.862 lekë.

³⁵ Në seancën dëgjimore subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të datës 29.10.2022, nga shtetasi B. T., në të cilën ai ka deklaruar se: “... për sa i përket marrëveshjes që kishte me përfaqësuesin e shoqërisë së ndërtimit, është lidhur vetëm kontrata e sipërmarrjes së ndërtimit të datës 03.02.2011 dhe më pas nuk kanë kryer asnjë veprim para ndonjë noteri. Gjithashtu, edhe për ndërprerjen e punimeve nuk kanë bërë asnjë kontratë apo deklaratë noteriale, pasi nuk kishin kontradikta dhe nuk e panë të nevojshme”... “...punimet kishin të bënin me përfundimin e jashtëm të godinës, përfundimin e punimeve të brendshme të katit përdhes, përfundimin e ndërtimit të papafingos, ndërsa dy katet e objektit, kati i parë dhe kati i dytë, nuk u përfunduan dhe nuk u bënë të shfrytëzueshme. Punimet që janë kryer në objekt, ishin për shitesë anësore dhe papafingo, pa prekur dhe cenuar objektin ekzistues ...”.

kryera në objektin ekzistues, të ndërtuar në vitin 2003, bazuar në preventivin e punimeve, si dhe faturave të lëshuara nga shoqëria ndërtuese.

27.2. Ndërsa, në lidhje me dy objektet me sipërfaqe 32 m² dhe 41 m², të legalizuara në vitin 2017, në mungesë të dokumentacionit ligjor, që provon koston reale të këtyre ndërtimeve, trupi gjykues, sikurse ka vlerësuar edhe Komisioni, vëren se referimi në çmimet sipas EKB-së për vitet 2010, 2011 dhe 2013, është jo vetëm alternativa e vetme për t'u përdorur në rrethanat faktike, por edhe në linjë me qëndrimet tashmë të konsoliduara të Kolegjit sa i përket situatave të ngjashme faktike. Pra, vlera totale e ndërtimit të këtyre dy objekteve ka qenë rreth 2.160.000 lekë³⁶ (sipërfaqe totale ndërtimi 73 m² * 29.580 lekë/m² = 2.159.340 lekë). Ndërsa, vlera totale për të gjitha ndërtimet e kryera në vitet 2010 – 2013, për punimet shtesë të kryera në objektin kryesor dhe për ndërtimin e dy objekteve të tjera, ka qenë në shumën 14.160.000 lekë.

28. Subjekti ka pretenduar se kursimet *cash*, për periudhën 2009 – 2010, në shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2011, nuk janë përdorur për të financuar mobilimin/kompletimin e restorantit, sikurse ka konkluduar Komisioni, por janë investuar në kryerjen e punimeve për ndërtimet shtesë. Fakt i cili rezulton i deklaruar nga subjekti edhe në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, kur subjekti është thirrur për të dhënë shpjegime lidhur me deklaratimet.

29. Trupi gjykues konstaton se në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni ka vlerësuar që kursimet në formë likuiditetesh *cash*, të deklaruara ndër vite dhe të pakësuara në vitin 2011, të mos i reflektojnë në analizën financiare si të ardhura, të cilat mund të kenë shërbyer si burim krijimi i pasurisë në analizë (*godinës dhe shtesave*, të regjistruara në emër të babait të subjektit), pasi i ka konsideruar ato si të shpenzuara plotësisht për ngritjen e aktivitetit “bar-restorant”, duke arsyetuar ndër të tjera se vlera e shpenzimeve prej 98.000 lekë, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, nuk i përgjigjet realitetit social-ekonomik për vitin e deklaruar/evidentuar, gjatë të cilit janë kryer këto shpenzime.

29.1. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për kryerjen e investimeve gjatë, periudhës 2010 – 2013, për ndërtimin e objektit trekatësh: (i) kredinë e marrë në BKT, në shumën 6.000.000 lekë; (ii) kursimet familjare (kursimet cash në vlerën prej 1.000.000 lekësh, të pakësuara në vitin 2011); si dhe (iii) të ardhurat nga shitja e një sipërfaqeje toke në pronësi të babait të tij.

29.2. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e të ardhurave nga kursimet *cash*, në shumën 1.000.000 lekë, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se gjendja *cash* është deklaruar në vitet përkatëse dhe përdorimi i saj është deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, konsiderimi i saj (i gjendjes *cash*) si burim për kryerjen e ndërtimeve shtesë, nuk do të ndryshonte situatën financiare të subjektit të rivlerësimit, por do të përmirësonte situatën financiare të prindërve për periudhën 2004 – 2016, nga (-) 2.435.584 lekë në (-) 1.435.584 lekë.

³⁶ Në deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit, citohet se objektet janë ngritur në vitin 2013. Nisur nga ky fakt, si dhe në referim të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri në datën 27.06.2014, me funksion banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë edhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj”, është konkluduar se dy objektet me sipërfaqe 32 m² dhe 41 m², minimalisht, janë ndërtuar para datës 27.06.2014 dhe, për rrjedhojë, Komisioni i është referuar çmimit të referencës së viteve 2013 – 2014.

30. Nga përmbajtja e ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka ngritur pretendime në lidhje me dy burimet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, konkretisht të ardhurat nga kredia e marrë në BKT, në shumën 6.000.000 lekë, si dhe të ardhurat nga shitja e një trualli, në pronësi të babait të subjektit, në vlerën 4.900.000 lekë. Megjithatë, trupi gjykues çmon të rëndësishme të ndalet në analizimin shkurtimisht të tyre, si më poshtë vijon:

30.1. Në lidhje me kredinë e marrë në BKT, trupi gjykues konstaton se, përpos deklaratimit në deklaratën *vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë kredi në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010 (kur është marrë). Referuar kontratës së kredisë, konstatohet se qëllimi i marrjes së kësaj kredie ka qenë porositja e një apartamenti me sipërfaqe 157.75 m², në vlerën 8.000.000 lekë, në qytetin e Durrësit. Kjo kontratë nuk është deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2010. Po ashtu, subjekti nuk ka deklaruar revokimin e saj, si dhe investimin e shumës në ndërtimin e shtesës së banimit me 2 kate dhe papafingo, në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2011.

30.2. Komisioni ka arritur në konkluzionin se shuma prej 3.000.000 lekësh, e depozituar nga subjekti, në datën 27.10.2010, në “Intesa Sanpaolo Bank”, nuk mund të ketë pasur si burim fondet e disbursuara nga kredia bankare në BKT dhe, si rrjedhim, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj depozite, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi administrativ i kryer, Komisioni ka konstatuar se në shkurt të vitit 2011 është revokuar kontrata e sipërmarrjes e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Në këto kushte, për një analizë garantiste, Komisioni ka vlerësuar të reflektojë si të ardhura që mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi, shumën e plotë të përfituar prej subjektit nga kredia e marrë në BKT, për sa kohë qëllimi i kryerjes së kësaj analize është në kuadrin e verifikimeve të dyshimeve për pasuri të fshehur.

30.3. Në lidhje me revokimin e kontratës së porosisë, për të cilën ishte marrë fillimisht kredia, gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka shpjeguar se për arsye objektive, kjo kontratë është revokuar dhe shuma e kredisë së marrë është investuar në banesën e prindërve të tij, në shtesën e objektit ekzistues. Në mbështetje të deklaratimit të tij, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 12.02.2011, në të cilën ndër të tjera citohet fakti i revokimit të kontratës së porosisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 15.09.2010, dhe se palët janë likuiduar financiarisht.

30.4. Nga aktet në fashikull ka rezultuar se shuma prej 5.887.000 lekësh, e pretenduar si burim për investimet e kryera në pasurinë në analizë, është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare. Po ashtu, nga aktet ka rezultuar se, në datën 27.10.2010, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në llogarinë e tij personale, në “Intesa Sanpaolo Bank”, shumën 3.000.000 lekë, me përshkrimin “Ilir Turja, për sa tërhequr nga BKT”, nga të cilat, deri në datën 16.12.2010, ka tërhequr pjesë-pjesë në total shumën prej 2.570.000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër, prej rreth 430.000 lekësh, ka qëndruar e depozituar në këtë llogari deri në fund të vitit. Nga verifikimi i informacionit dhe i dokumentacionit të dërguar nga BKT-ja, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë tërhequr nga kjo bankë shumën prej 3.000.000 lekësh, por u konstatua se fondet e disbursuara nga kredia janë transferuar në një llogari tjetër, në dukje për likuidimin e çmimit të apartamentit, në përmbushje të kontratës së lidhur për porositje të apartamentit. Nga ana tjetër, në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit nuk

ka deklaruar gjendjen e llogarisë (datë 31.12.2010), në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe, si rrjedhim, as burimin e krijimit të kësaj pasurie.

30.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në Komision, subjekti i rivlerësimit ka pranuar se shuma prej 3.000.000 lekësh i është kthyer nga shoqëria në vitin 2010. Ndërsa, referuar deklaratës noteriale të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, revokimi është kryer në vitin 2011, fakt që lë të perceptohet se pjesa e mbetur prej 2.877.000 lekë është kthyer në këtë vit. Subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 28.10.2022, të shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën shpjegohet se shuma e kredisë fillimisht i është kaluar kësaj shoqërie dhe, pas zgjidhjes së kontratës, i është kthyer subjektit.

31. Në eventualitetin e fakteve të sipërpërkshkruara, trupi gjykues e gjen të pabesueshëm/pabazuar deklarin e subjektit, të pranuar edhe nga Komisioni, i cili i ka përlllogaritur si burim për krijimin e pasurisë të ardhurat në shumën 3.000.000 lekë, që sipas subjektit të rivlerësimit buronin nga kredia në BKT. Megjithatë, në kushtet kur, sikurse është cituar edhe më sipër në këtë vendim, Komisioni në përfundim të analizës ligjore e financiare, në një frymë garantiste ndaj subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar se shuma e kredisë është përdorur si burim për krijimin e pasurisë në analizë, trupi gjykues vlerëson se në të njëjtën logjikë do të duhet të vazhdojë edhe analiza financiare në Kolegj, pavarësisht se përsëri subjekti ka mungesë së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

32. Në lidhje me të ardhurat në vlerën 4.900.000 lekë nga tjetërsimi i pasurisë së llojit “arë” me sipërfaqe 600 m², e ndodhur në {***}, Durrës, në pronësi të babait të subjektit, të deklaruara si një ndër burimet e krijimit të pasurisë në analizë, trupi gjykues, nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare.

32.1. Në analizë të akteve në fashikull, trupi gjykues konstaton se pasuria e sipërpërmendur është blerë në datën 02.06.2005, nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, në çmimin prej 500.000 lekësh, dhe e kanë shitur atë në datën 06.09.2006, në shumën prej 4.900.000 lekësh³⁷. Pra, shitja e kësaj pasurie është bërë rreth një vit më pas, në një vlerë rreth 10 herë më të lartë se çmimi i blerjes.

33. Trupi gjykues konstaton se, përveç kontratës së shitblerjes, subjekti nuk ka depozituar ndonjë dokument ligjor që do të dëshmonte lidhur me kohën dhe mënyrën e marrjes së kësaj shume nga prindërit e tij. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur ndonjë mandatpagesë të tatimit të paguar nga prindërit e tij, për të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj pasurie, duke e pamundësuar në këtë mënyrë gjurmimin e këtyre të ardhurave, për shkak edhe të mënyrës së likuidimit të tyre *cash* nga blerësi. Nga ana tjetër, nuk rezulton që Komisioni të ketë hetuar më tej në drejtim të verifikimit të regjistrimit të kësaj prone në emrin e blerësit, sipas kontratës së shitblerjes. Megjithatë, sikurse është vlerësuar më sipër në lidhje me burimin e të ardhurave nga kredia, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, për sa kohë Komisioni i ka konsideruar të ardhurat nga ky transaksion, trupi

³⁷ Subjekti ka paraqitur në Komision në cilësinë e provave disa kontrata shitblerje dhe kartela të pasurive të paluajtshme në emër të z. Sh. Nga analizimi i këtyre provave, konstatohet se pasuritë janë regjistruar në të njëjtën datë, si dhe pozicionohen në të njëjtën zonë kadastrale, atë me nr. {***}, dhe kanë numrat si vijon: nr. pasurie {***}, me nr. pasurie {***}, me nr. pasurie {***}, me nr. pasurie {***}, me nr. pasurie {***}, me nr. pasurie {***}. Konkretisht, pasuria me nr. {***}, me sip. 3000 m², është shitur në vlerën 7.293.600 lekë; pasuria me nr. {***}, me sip. 2400 m², është shitur në vlerën 5.909.800 lekë; pasuria me nr. {***}, me sip. 680 m², është shitur në vlerën 3.900.000 lekë; pasuria me nr. {***}, me sip. 1800 m², është shitur në vlerën 5.070.500 lekë; pasuria me nr. {***}, me sip. 7300 m², është shitur në vlerën 21.150.000 lekë; pasuria me nr. {***}, me sip. 490 m², është shitur në vlerën 25.000 euro.

grykues vlerëson se në të njëjtën logjikë do të duhet të vijojë edhe analiza financiare në Kolegjin e Posaqëm të Apelimit.

34. Subjekti ka pretenduar që balanca negative e konstatuar nga Komisioni, në shumën 1.300.000 lekë, të vlerësohet nga Kolegji sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, si një balancë negative e vogël, që nuk mund të justifikojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
35. Në analizë të këtij shkakut ankimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykes vlerëson se parimi i proporcionalitetit dhe i objektivitetit, nuk mund të gjejë zbatim në rrethanat kur subjekti dhe prindërit e tij rezultojnë me një balancë të lartë negative, e për më tepër, në rastin konkret është konkluduar për fshehje të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit. Në vlerësim të trupit gjykes, ky parim nuk mund të zbatohet në këtë rast dhe të interpretohet i shkëputur me problematikat e analizuar më sipër, në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit Ilir Turja.
36. Në ankim, përpos pretendimeve të ngritura lidhur me pasurinë në përdorim të tij dhe në pronësi të babait, subjekti ka kundërshtuar edhe konkluzionin e Komisionit për deklaram të pasaktë dhe të paplotë nga bashkëshortja e tij, sa i takon pasurisë “Apartament banimi” në Tiranë, në pronësi të saj (e përfutur prej saj përpara fillimit të bashkëjetesës) dhe në përdorim të subjektit për periudhën nëntor 2009 deri në tetor të vitit 2010.
37. Nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykes konstaton se Komisioni, në mungesë të evidencave apo të të dhënave të tjera mbi marrëdhënie bashkëjetese të subjektit me personin e lidhur, ka vlerësuar të mos analizojë ligjshmërinë e burimeve financiare me të cilat ajo është krijuar, duke argumentuar se kjo rrethanë nuk mund të ndikojë në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit Ilir Turja. Nga ana tjetër, Komisioni ka çmuar se gjetjet e evidentuara mbi deklaramet dhe/apo mosdeklaramet e bëra nga subjekti/personi i lidhur në deklaramtën e rivlerësimit kalimtar *vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, e çojnë subjektin e rivlerësimit në situatën e një deklarami të pasaktë, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- 37.1. Trupi gjykes konstaton se pasuria “Apartament banimi”, me sipërfaqe 67,8m² në Tiranë, e ka origjinën nga kontrata e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.06.2007, ku përcaktohej porositja e apartamentit me sipërfaqe 73 m², me vlerë 35,000 euro dhe se pala porositëse do të paguante fillimisht shumën 15,000 euro, ndërsa për pagesën e shumës 20,000 euro do të merrte kredi në bankë. Kjo banesë i ka kaluar në pronësi babait të subjektit të rivlerësimit, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.11.2011, kundrejt çmimit të blerjes prej 25,754 euro dhe është regjistruar sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. {***}, të ZVRPP-së Tiranë, me adresë të pasurisë: Selitë, Tiranë, apartament me sipërfaqe 67.8 m², ndodhur në z. k. {***}.
- 37.2. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga: (i) puna e saj e kryer ndër vite – përfshirë edhe të ardhurat e krijuara nga puna e kryer në Itali; (ii) kursimet e familjes së saj (prindërve) – duke specifikuar se nëna e saj ka tërhequr nga “Raiffeisen Bank” në atë kohë shumën prej 867.071 lekësh – me qëllim blerjen e apartamentit; dhe (iii) kredia bankare në “NBG Bank”, në shumën prej 20,000 euro.
38. Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” – të deklaramtës së pasurisë *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar kredinë e marrë në “NBG Bank”, në shumën 20,000 euro. Gjithashtu, konstatohet se në deklaramtat e interesave privatë të viteve 2010 – 2016, subjekti i

rivlerësimit ka deklaruar si detyrim kredinë bankare të marrë nga bashkëshortja në “NBG Bank”, si dhe shlyerjet vjetore të kryera për këtë kredi. Në DIPP-në 2016 ka deklaruar se detyrimi i mbetur ndaj “NBG Bank” lidhur me këtë kredi, ka qenë në shumën 9,184 euro.

38.1. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, Komisioni ka arritur në konkluzionin se kjo pasuri është porositur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit përpara se ata të fillonin bashkëjetesën. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar të mos analizojë ligjshmërinë e burimeve financiare të krijimit të pasurisë nga bashkëshortja e subjektit, duke e vlerësuar si rrethanë që nuk mund të ndikojë në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit Ilir Turja.

39. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të ndodhur në dosjen gjyqësore, si dhe në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se gjetjet e evidentuara mbi deklaratimet dhe/apo mosdeklaratimet e subjektit/personit të lidhur, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, e çojnë subjektin e rivlerësimit në situatën e një deklarimi të pasaktë, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
40. Për sa më sipër, faktet e evidentuara mbështesin konkluzionin e arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të pasurisë nga personi i lidhur, duke u gjendur në kushtet e deklaratimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Trupi gjykues çmon se subjekti, krahas detyrimit për deklarimin e pasurisë së tij dhe personit të lidhur, bazuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka pasur detyrimin që të depozitonte dokumentacionin justifikues, që provon vërtetësinë e deklaratimeve të tij në kuadër të parashikimeve të këtij ligji.
41. Në përfundim të sa është analizuar më sipër, për pasurinë “Banesë trekatëshe”, si dhe shtesave të kryera në lidhje me të, trupi gjykues vëren se, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk figuron pronar apo bashkëpronar mbi këtë pasuri, ai rezulton se ka kryer investime të konsiderueshme mbi të, si dhe ka përdorur, qoftë edhe një pjesë të kësaj pasurie, gjatë periudhës 2003 – 2016, fakte të cilat janë pranuar prej tij. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit evidentohet si investitor për shpenzime të kryera për rinovimin, ndërtimin e shtesave dhe ndryshimet e bëra në objektin e regjistruar në emër të babait të tij. Konkretisht: (i) fondet e përfituara nga kredia e vitit 2004, në “ProCredit Bank” (ku evidentohet si bashkëkredimarrës me babain) duket se kanë shërbyer për rinovime në banesën e ndërtuar në vitin 2003; (ii) fondet e përfituara nga kredia e marrë në vitin 2010, në BKT, janë vetëdeklaruar prej tij si të investuara në punimet për ndërtimet shtesë të kryera në objektin ekzistues; si dhe (iii) kursimet nga paga e subjektit janë deklaruar si të investuara në këtë pasuri, konkretisht në “Procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”, të mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 09.02.2016”, subjekti ka deklaruar se pakësimi i kursimeve *cash* në shumën prej 1.000.000 lekësh, në fund të vitit 2011, është bërë për arsye se kjo shumë është investuar në banesën e prindërve të tij.
- 41.1. Në analizën financiare të kryer për këtë pasuri, trupi gjykues ka konkluduar se shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës trekatëshe në vitin 2003, do të reflektohen në vlerën 7.500.000 lekë, dhe për ndërtimet shtesë të realizuara në periudhën kohore 2010 – 2013, do të reflektohen në vlerën 14.160.000 lekë.
42. Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2003 – 2016, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit paraqitet me një balancë negative fondesh, në total në vlerën rreth (-) 1.300.000 lekë. Kjo balancë negative ka rezultuar për shkak se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara si burim për krijimin e pasurisë në

analizë, pretendime të cilat, sikurse është analizuar më sipër, i ka ngritur edhe në ankimin e depozituar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

43. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit u përlllogarit mundësia financiare e subjektit (së bashku me personat e lidhur) si dhe prindërve të tij për periudhën 1995 – 2003, gjatë së cilës është kryer investimi fillestar për ndërtimin e banesës trekatëshe, nga ku u konkludua për një mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruar dhe të evidentuara, në vlerën (-) 6.605.740 lekë, për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
44. Për sa i përket periudhës 2004 – 2013 (vit në të cilin është deklaruar përfundimi i ndërtimit), gjatë së cilës janë kryer punime shtesë në objektin trekatësh, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për ndërtimin e shtesave në vlerën (-) 1.435.584 lekë.
45. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer veçmas për subjektin e rivlerësimit, për periudhën 2004 – 2016, u arrit në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit paraqitet me një balancë negative fondesh, në total në vlerën rreth (-) 1.303.852 lekë. Kjo balancë negative ka rezultuar për shkak se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor ligjshmërinë e burimeve për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën e sipërpërmendur, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
46. Në lidhje me pasurinë objekt banimi trekatësh dhe shtesat anësore të kryera në lidhje me të, si dhe dy godina social-ekonomike, të regjistruara në regjistrat publikë, në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit, të ndodhura në Lagjen nr. {***}, Plazh, Durrës, subjekti dështoi të provojë që ato nuk i përkisnin atij, për pasojë konkluzioni i Komisionit se këto përbëjnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar dhe ai gjendet në kushtet e nenit 33 pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë sa vijon:
 - i. Subjekti dështoi të provojë mundësinë e krijimit të këtyre pasurive me burime financiare të ligjshme, duke rezultuar me mungesë të theksuar të tyre, si për prindërit, ashtu dhe për subjektin e rivlerësimit, e atillë që e bën të pamundur përmbysjen e barrës së provës, pavarësisht problematikave për të cilat Komisioni ka pranuar si të vërteta burimet/veprimet e paqarta të subjektit të rivlerësimit.
 - ii. Nuk ka deklaruar asnjëherë plotësisht të drejtat dhe marrëdhënien e tij me këto pasuri, vlerën e tyre dhe ndryshimet që ato kanë pësuar ndër vite, ndonëse ka kryer investime të konsiderueshme, si dhe rezulton të shfaqet si një investitor për krijimin e tyre.
 - iii. Interesat e tij financiare me këto pasuri janë të ndërthurura në mënyrë të pazgjdhshme dhe të vazhdueshme.
 - iv. Bashkëshortja e tij ushtron aktivitet tregtar fitimprurës në ambientet e krijuara nga ky investim.
47. Për sa më sipër, pas kontrollit të analizës financiare të kryer në Komision, trupi gjykues konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme, për krijimin e pasurive dhe të shpenzimeve të tjera të deklaruar prej subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, pasi gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas përcaktimit në nenin 33, pika 5, shkronja “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.
48. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, në raport me provat shkresore të administruara në dosjen hetimore të kësaj çështjeje, bazuar në konkluzionet e

mësipërme, duket se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, nën dritën e përcaktimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 584, datë 07.11.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ilir Turja, është i drejtë dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 584, datë 07.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ilir Turja.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.01.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi